

LIGJI NR.08/L-172**PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE****Kuvendi i Republikës së Kosovës**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë që produktet e vendosura në treg të jenë të sigurta.
2. Ky ligj përcakton kërkesën e përgjithshme të sigurisë për produktet, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, informimin e publikut, nxitjen/marrjen e masave vullnetare dhe mbikëqyrjen inspektuese për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara.
3. Ky ligj është plotësisht në përputhje me Direktivën 2001/95/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 3 dhjetorit 2001 për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Direktivën 357/87/EC të 25 qershorit 1987 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për imitimin e produkteve ushqimore.

Neni 2**Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet e përkufizuara në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për produktet të cilat nuk janë të mbuluara me akte të veçanta ligjore të transpozuar në Republikën e Kosovës me të njëjtën objektivë që rregullojnë sigurinë e produkteve.
2. Nëse aktet e veçanta ligjore nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mbulojnë të gjitha llojet dhe kategoritë e rreziqeve që mund të paraqesë produkti, ky ligj do të zbatohet vetëm në lidhje me ato lloje dhe kategori të rreziqeve.
3. Ky ligj nuk zbatohet për produktet e përdorura që dorëzohen si antike dhe produktet që duhet të riparohen ose ripërpunohen para përdorimit për të njëjtin qëllim, me kusht që furnizuesi të informojë qartë paraprakisht personin të cilit ia dorëzon produktin.

Neni 3**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet e përcaktuara në këtë nen.
2. **Produkt** - çdo produkt i ri, i përdorur ose i riparuar, i destinuar për konsumatorët ose përdoruesit e tjerë ose që në kushte arsyeshëm të parashikueshme mund të përdoret nga konsumatorët ose përdoruesit e tjerë edhe nëse nuk është destinuar për ta, dhe që furnizohet ose vihet në dispozicion të tyre, në kuadër të një veprimtarie tregtare, duke përfshirë produktet

në kontekstin e ofrimit të shërbimeve, pavarësisht nëse merren parasysht apo jo.

3. **Produkt i rrezikshëm** - çdo produkt që nuk është i sigurt sipas nenit 4 të këtij ligji.

4. **Produkt mashtrues** - produkti i imituar me pamje mashtruese, që nuk është produkt ushqimor, por ka formë, erë, ngjyrë, dukje të jashtme, ambalazh, shenjë, vëllim ose madhësi të produktit ushqimor, ashtu që konsumatori, sidomos fëmija, të mund ta ngatërrojë me produktin ushqimor dhe ta vërë në gojë, thithë ose gëlltisë, çka mund të paraqesë rrezik ose të shkaktojë, ngulfatje helmim, shpim ose pengesa në traktin e tretjes.

5. **Prodhues** nënkupton:

5.1. prodhuesi i produktit që ka selinë në Republikën e Kosovës dhe çdo person juridik ose fizik që paraqitet si prodhues, vendos në produkt emrin e tij, markën tregtare ose ndonjë shenjë tjetër dalluese, ose e përpunon produktin;

5.2. përfaqësuesi i prodhuesit, kur prodhuesi nuk është i regjistruar në Republikën e Kosovës;

5.3. importuesi i produktit, nëse prodhuesi ose përfaqësuesi i tij nuk është i regjistruar në Republikën e Kosovës;

5.4. profesionistë të tjerë në zinxhirin e furnizimit, për aq sa veprimtaritë e tyre mund të ndikojnë në karakteristikat e sigurisë së një produkti.

6. **Shpërndarës** - çdo profesionist në zinxhirin e furnizimit, aktiviteti i të cilit nuk ndikon në karakteristikat e sigurisë së produktit.

7. **Rrezik serioz** - çdo rrezik për sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve, pavarësisht kur efekti është manifestuar, që kërkon ndërhyrje të shpejtë nga inspektorati kompetent.

8. **Vënia në dispozicion në treg** - çdo porosi e një produkti për shpërndarje, konsum ose përdorim në tregun e Republikës së Kosovës në kuadër të veprimtarisë tregtare, me apo pa pagesë.

9. **Vendosja në treg** - vendosja e parë e produktit në dispozicion për tregun e Republikës së Kosovës nga prodhuesi ose importuesi.

10. **Tërheqja e produktit** - çdo masë që synon parandalimin e shpërndarjes, ekspozimit dhe ofrimit të një produkti të rrezikshëm për konsumatorët dhe përdoruesve të tjerë.

11. **Kthimi i produktit** - çdo masë që synon kthimin e produktit që tashmë është dorëzuar nga prodhuesi ose shpërndarësi ose është vënë në dispozicion të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë.

12. **Sistemi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit për produktet që paraqesin rrezik** - sistem për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme në Republikën e Kosovës, i cili aplikohet nga inspektoratet kompetente dhe Dogana e Kosovës.

13. **RAPEX** - sistemi i shkëmbimit të shpejtë të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian për masat dhe aktivitetet e ndërmarra në lidhje me rrezikun serioz që paraqet një produkt i rrezikshëm ndaj shëndetit dhe sigurisë e konsumatorëve.

14. **Legjislacioni i harmonizuar i Bashkimit Evropian** - legjislacioni i harmonizuar në Bashkimin Evropian i cili përcakton kushtet për tregtimin e produkteve.

15. **Legjislacioni i harmonizuar i Republikës së Kosovës** - legjislacioni i Bashkimit Evropian i transpozuar në legjislacion të brendshëm nga Republika e Kosovës.

16. **Konsumator** - personi fizik të cilit produkti i dorëzohet ose i vihet në dispozicion dhe i cili e përdor produktin për nevoja personale ose shtëpiake.

17. **Përdorues tjetër** - çdo person të cilit produkti i dorëzohet ose i vihet në dispozicion dhe i cili e përdor ose shfrytëzon produktin për nevojat e veta, përkatësisht për kryerjen e veprimtarisë së tij.

18. **Ndalim tregtimi** - çdo masë e ndërmarrë për të ndaluar shpërndarjen, ekspozimin dhe ofrimin e produktit i cili vërtetohet se është i rrezikshëm për konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë.

19. **Inspektorati kompetent** - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë.

20. **Ministria** - ministria përgjegjëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë.

21. **Ministri** - ministri apo ministrja përgjegjës/e për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë.

Neni 4 **Produkt i sigurt**

1. Produkt i sigurt është çdo produkt që, në kushte normale ose arsyeshëm të parashikueshme të përdorimit, duke përfshirë periudhën në të cilën produkti është përdorur, si dhe kërkesat e zbatueshme të vënies në punë, instalimit dhe mirëmbajtjes, nuk paraqet asnjë rrezik ose paraqet rrezik minimal në përputhje me përdorimin e produktit dhe që konsiderohet i pranueshëm dhe në përputhje të qëndrueshme me një nivel të lartë të mbrojtjes të sigurisë dhe shëndetit të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë. Për përcaktimin e produktit të sigurt, merren parasysh në veçanti:

1.1. karakteristikat e produktit, përfshirë përbërjen, paketimin, udhëzimet për montim, instalim dhe mirëmbajtje;

1.2. ndikimi në produkte të tjera, kur mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme se produkti do të përdoret me produkte të tjera;

1.3. paraqitja e produktit, për sa i përket ekspozimit, etiketimit, paralajmërimeve dhe udhëzimeve për përdorimin dhe asgjësimin, ruajtjen ose shkatërrimin e tij pas përdorimit, si dhe çdo shenjë tjetër ose informacion mbi produktin;

1.4. pamja e produktit, sidomos e produktit joushqimor, i cili mund të çorientojë konsumatorin, nëse forma, aroma, ngjyra, pamja, paketimi, etiketimi, vëllimi, madhësia ose karakteristikat e tjera i ngjajnë një produkti ushqimor dhe si pasojë mund të përdoret nga konsumatorët, sidomos nga fëmijët, në një mënyrë që mund të paraqesë rrezik për shëndetin dhe jetën e tyre, si ngulfatja, helmimi ose problemet me sistemin e tretjes për shkak të futjes së produktit në gojë, thithjes ose gëlltitjes;

1.5. kategoritë e konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë në rrezik kur përdorin një produkt të caktuar, sidomos fëmijët dhe të moshuarit.

2. Mundësia e arritjes së niveleve më të larta të sigurisë ose disponueshmëria e produkteve të tjera që paraqesin shkallë më të vogël rreziku nuk përbën bazë për ta konsideruar një produkt të rrezikshëm.

Neni 5 **Përgjegjësia e prodhuesit**

1. Kufizimi për vendosjen në treg dhe vënien në dispozicion në treg të produkteve, tërheqjen ose kthimin e tyre nuk përjashton përgjegjësinë penale të prodhuesit ose shpërndarësit në përputhje me legjislacionin përkatës për çështjet penale.
2. Përbushja e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj nuk përjashton përgjegjësinë civile të prodhuesve për dëmin e shkaktuar nga një produkt i dëmtuar, në përputhje me ligjin përkatës për marrëdhëniet e detyrimeve.
3. Vendimi për kufizimin e vendosjes në treg, tërheqjes ose kthimit të produktit sipas këtij ligji, nuk paragjykon përgjegjësinë penale të prodhuesit.

KAPITULLI II **KËRKESA E PËRGJITHSHME E SIGURISË DHE KRITERET E SIGURISË**

Neni 6 **Kërkesa e përgjithshme e sigurisë**

1. Prodhuesi duhet të vendosë në treg vetëm produkte të sigurta.
2. Ndalohet prodhimi, importi, eksporti dhe vendosja e produkteve mashtruese në treg.

Neni 7 **Kriteret për vlerësimin e konformitetit dhe standardet e harmonizuara**

1. Produkti konsiderohet i sigurt nëse i plotëson kërkesat e sigurisë dhe shëndetit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Produkti konsiderohet i sigurt për sa i përket rrezikut ose kategorive të rrezikut nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në përputhje me standardet përkatëse të harmonizuara kosovare që rregullojnë kategori të tilla të rrezikut, të cilat i adoptojnë standardet evropiane të publikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
3. Lista me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara kosovare sipas paragrafit 2 të këtij neni miratohet me vendim nga ministri i ministrisë dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 8 **Kriteret e tjera të sigurisë**

1. Në mungesë të legjislacionit në fuqi dhe standardeve të veçanta nga neni 7 i këtij ligji, përputhshmëria e një produkti me kërkesën e përgjithshme të sigurisë vlerësohet mbështetur në:
 - 1.1. standardet kosovare të miratuara në bazë të standardeve përkatëse evropiane të ndryshme nga ato të deklaruara në listën e standardeve të përcaktuara në nenin 7 paragrafin 2 të këtij ligji;
 - 1.2. standardet e tjera kosovare;
 - 1.3. rekomandimet e Komisionit Evropian, që caktojnë udhëzime për vlerësimin e sigurisë së produktit;

- 1.4. kodet e praktikave të mira lidhur me sigurinë e produktit në sektorin përkatës;
- 1.5. nivelin e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë;
- 1.6. pritjet e arsyeshme të konsumatorëve lidhur me sigurinë.

2. Përputhshmëria e produktit me kërkesën e përgjithshme të sigurisë vlerësohet nga prodhuesi ose shpërndarësi dhe nga inspektorati kompetent me kryerjen e vlerësimit të rrezikut, sipas këtij ligji.

Neni 9 Klauzola mbrojtëse

Nëse inspektorati kompetent konstaton se një produkt nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme të sigurisë, edhe pse i plotëson kriteret e sigurisë nga nenet 7 dhe 8 të këtij ligji, inspektorati merr masat e duhura sipas nenit 18 të këtij ligji.

KAPITULLI III DETYRIMET E PRODHUESVE DHE SHPËRNDARËSVE

Neni 10 Detyrimet e prodhuesve

1. Prodhuesit duhet t'u sigurojnë konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë informacionin dhe paralajmërimet përkatëse, për t'u mundësuar të vlerësojnë rreziqet dhe të marrin masa paraprake kundër rreziqeve gjatë përdorimit të produktit kur këto rreziqe nuk janë menjëherë të dukshme pa një informacion dhe paralajmërim të tillë, gjatë gjithë përdorimit normal ose periudhës arsyeshme të parashikueshme të përdorimit. Ofrimi i informatave dhe paralajmërimeve të nevojshme nuk i liron prodhuesit nga detyrimet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Prodhuesi, në bazë të karakteristikave të një produkti që e vendos në treg, duhet të marrë masa që i mundësojnë:

- 2.1. të informohet për rreziqet që mund të paraqesin këto produkte;
- 2.2. të paralajmërojë konsumatorët menjëherë për rreziqet e vlerësuara dhe të identifikuara;
- 2.3. të tërheq ose të kthejë produktin në mënyrë që të shmangë rreziqet.

3. Masat nga paragrafi 2 i këtij neni konsiderohen të jenë në veçanti:

- 3.1. testimi i mostrave të produkteve në treg kur është e nevojshme dhe përpunimi i informacionit;
- 3.2. vendosja e një etikete në një produkt ose në paketim që i referohet identitetit të prodhuesit dhe produktit ose kur është e nevojshme një grupi produktesh që i përket;
- 3.3. të vepruarit sipas ankesave dhe nëse është e nevojshme menaxhimi i një regjistri të ankesave;
- 3.4. informimi i shpërndarësve për masat nga nënparagrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni.

4. Masat e referuara në paragrafin 2, nënparagrafët 2.2 dhe 2.3 të këtij neni merren vullnetarisht nga prodhuesi ose me kërkesë të inspektoratit kompetent.

5. Masa që i referohet kthimit të një produkti merret si mjete i fundit nëse prodhuesi ose inspektorati i mbikëqyrjes së tregut konstaton se masat e tjera nuk janë të mjaftueshme për të eliminuar ose minimizuar një rrezik por ato gjithashtu mund të zbatohen në bazë të rregullit të praktikave të mira në lidhje me kthimin e një produkti.

6. Sigurimi i informacionit dhe paralajmërimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk përjashton prodhuesin ose shpërndarësin e përfshirë në zinxhir furnizimi nga detyrimi i pajtueshmërisë me kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 11 **Detyrimet e shpërndarësve**

1. Shpërndarësit duhet të veprojnë me kujdesin e profesionistit të mirë për të ndihmuar në sigurimin e përputhshmërisë së produktit me kërkesat e zbatueshme të sigurisë.

2. Shpërndarësi nuk mund të vë në dispozicion në treg produkte për të cilat ai e di ose duhet të prezumojë, në bazë të informacionit që posedon dhe si profesionist, se janë të rrezikshme.

3. Gjatë kryerjes së aktiviteteve, shpërndarësi merr pjesë në monitorimin e sigurisë së produkteve që vë në dispozicion në treg, në veçanti:

3.1. duke siguruar informacion në lidhje me rreziqet për pjesëmarrësit në zinxhirin e furnizimit, konsumatorët dhe inspektoratin kompetent për mbikëqyrjen e tregut;

3.2. duke mbajtur dhe siguruar dokumentet e nevojshme për gjurmimin e origjinës së produkteve dhe identitetin e prodhuesit, me kërkesë të inspektoratit kompetent ose profesionistëve në zinxhirin e furnizimit.

Neni 12 **Detyrimet e tjera të prodhuesve dhe shpërndarësve**

1. Nëse prodhuesi ose shpërndarësi, në bazë të informacionit që disponon, njohurive ose përvojës profesionale, e di ose duhet ta dijë se produkti që ka vendosur në treg është i rrezikshëm, ai duhet të njoftojë menjëherë inspektoratin kompetent.

2. Njoftimi sipas paragrafit 1 të këtij neni dorëzohet me shkrim dhe duhet të përmbajë në veçanti:

2.1. informacionin dhe të dhënat që mundësojnë identifikimin e produktit (prodhuesit, emrin e produktit, grupin/serinë e produkteve dhe të ngjashme) për të gjurmuar produktin;

2.2. përshkrimin e hollësishëm të rrezikut që paraqet produkti;

2.3. përshkrimin e masave dhe veprimeve të ndërmarra për të shmangur rrezikun.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton formën dhe detajet e njoftimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Prodhuesit dhe shpërndarësit duhet të njoftojnë sipas kërkesës inspektoratin kompetent për veprimet e ndërmarra për të shmangur rreziqet që vijnë nga produktet që ata i furnizojnë apo tashmë i kanë furnizuar.

Neni 13 **Procedurat e bashkëpunimit dhe nxitja e masave vullnetare**

1. Inspektoratet kompetente inkurajojnë prodhuesit dhe shpërndarësit të marrin masa vullnetare në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe kështu të mbështesin krijimin e rregullave të praktikës së mirë dhe vënien në dispozicion të tregut të produkteve ekskluzivisht të sigurta.

2. Inspektoratet kompetente vendosin procedurat e bashkëpunimit të përcaktuara në nenin 12 paragrafi 4 të këtij ligji dhe i publikojnë ato në ueb faqen e Trupit Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut, siç përcaktohet me Ligjin në fuqi që rregullon mbikëqyrjen e tregut të produkteve.

KAPITULLI IV INFORMIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 14 Publikimi i informacionit

1. Informacioni në dispozicion për inspektoratet kompetente në lidhje me rreziqet që paraqesin produktet për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë, dhe informacioni për identifikimin e produktit, natyrën e rrezikut dhe masat e marra duhet të jenë në dispozicion të publikut, në përputhje me parimet e transparencës dhe pavarësisht çdo kufizimi të vendosur nga aktivitetet monitoruese dhe kërkimore. Informacioni për identifikimin e produktit, natyrën e rrezikut dhe masat e marra janë veçanërisht në dispozicion për publikun.
2. Inspektoratet kompetente sigurojnë që punonjësve të tyre dhe personave të autorizuar u kërkohet të mos zbulojnë informacionin e marrë gjatë punës së tyre, i cili përbën sekret tregtar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Informacioni në lidhje me karakteristikat e sigurisë së një produkti, i cili duhet të jetë publik për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë, nuk mund të konsiderohet si sekret tregtar.
4. Ruajtja e sekretit tregtar të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni nuk duhet të ndikojë në shkëmbimin e informacionit ndërmjet inspektorateve kompetente në Republikën e Kosovës për të siguruar monitorim dhe mbikëqyrje efektive të tregut.
5. Ruajtja e sekretit tregtar të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni nuk duhet të ndikojë në shkëmbimin e informacionit ndërmjet inspektorateve kompetente të Republikës së Kosovës dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian.

Neni 15 Shkëmbimi i informacionit për produktet e rrezikshme në Republikën e Kosovës

1. Inspektoratet kompetente dhe Dogana e Kosovës shkëmbejnë informacione në lidhje me produktet e rrezikshme përmes sistemit për shkëmbim të informacionit të shpejtë mbi produktet që paraqesin rrezik, kur:
 - 1.1. inspektorati kompetent merr një masë të përcaktuar në lidhje me një produkt të rrezikshëm;
 - 1.2. prodhuesi ose shpërndarësi merr masa vullnetare në lidhje me produktin e rrezikshëm që e ka vënë në dispozicion në treg dhe njofton inspektoratin kompetent në përputhje me nenin 12 të këtij ligji.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton, mënyrën e funksionimit të sistemit të shkëmbimit të shpejtë të informacionit dhe format e njoftimit për produktet e rrezikshme që gjenden në tregun e Republikës së Kosovës.

Neni 16 Shkëmbimi i informacionit në lidhje me produktet e rrezikshme me Bashkimin Evropian

1. Inspektorati kompetent përdor sistemin RAPEX për të njoftuar Komisionin Evropian për produktet e rrezikshme në tregun e Republikës së Kosovës që paraqesin rrezik që nuk lejohet, në përputhje me këtë ligj.

2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni i dërgohet Komisionit Evropian nëse konsiderohet se produkti i rrezikshëm i vënë në dispozicion në treg mund të shkaktojë rrezik përtej territorit të Republikës së Kosovës.
3. Pas njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni, autoriteti përgjegjës duhet të informojë Komisionin Evropian gjithashtu për masat e marra nga inspektorati kompetent, duke saktësuar arsyet për miratimin e tyre, si dhe për çdo modifikim ose heqje të masave të tilla.
4. Pas njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni, autoriteti përgjegjës, nëse konstaton se ka të bëjë me një rrezik serioz, duhet të njoftojë Komisionin Evropian për masat e ndërmarra vullnetarisht nga operatorët ekonomikë.
5. Nëse inspektorati kompetent konsideron se produkti i rrezikshëm i vënë në dispozicion në treg nuk mund të shkaktojë rrezik përtej territorit të Republikës së Kosovës, njofton Komisionin Evropian për masat e marra për aq sa përfshijnë informacion që mund të jetë me interes për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nëse merren për të parandaluar, eliminuar ose zvogëluar një rrezik të ri i cili ende nuk është raportuar tek Komisioni Evropian.
6. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbajë të gjithë informacionin në dispozicion, në veçanti informacionin që mundëson identifikimin e produktit, origjinën dhe zinxhirin e furnizimit të produktit, rrezikun e përcaktuar, natyrën dhe kohëzgjatjen e masës së detyrueshme të ndërmarrë si dhe masat vullnetare të marra nga prodhuesit dhe shpërndarësit.
7. Paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni nuk përjashtojnë detyrimin për të shkëmbyer informacione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI V MBIKËQYRJA E TREGUT

Neni 17

Kompetencat e mbikëqyrjes inspektuese dhe Doganës

1. Mbikëqyrja inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore nga ky ligj kryhet nga inspektorati kompetent në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, ligjin përkatës për mbikëqyrjen e tregut dhe rregulloren për grupet e produkteve të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese.
2. Dogana e Kosovës kontrollon produktet e importuara gjatë procedurës për lejimin e qarkullimit të lirë, në përputhje me ligjin përkatës që rregullon mbikëqyrjen e tregut të produkteve.

Neni 18

Masat

1. Kur është e përshtatshme për qëllimet e këtij ligji, inspektoratet kompetente mund të marrin masat si në vijim:
 - 1.1. për çdo produkt:
 - 1.1.1. të organizojnë, edhe pasi të jetë vënë në treg si produkt i sigurt, kontroll të përshtatshëm për karakteristikat e tij të sigurisë në një shkallë të përshtatshme deri në fazën përfundimtare të përdorimit ose konsumimit;
 - 1.1.2. të kërkojnë të gjitha informacionet e nevojshme nga palët e interesit;
 - 1.1.3. të marrin mostra të produktit dhe të kryejnë kontrollin e sigurisë.

1.2. për çdo produkt që mund të paraqesë rreziqe në kushte të caktuara:

1.2.1. të urdhërojë që produkti të shënjohe me paralajmërime të përshtatshme, të qarta dhe lehtë të kuptueshme për rreziqet që mund të paraqesë produkti në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;

1.2.2. të urdhërojë vendosjen në treg të një produkti të tillë me plotësimin paraprak të kushteve shtesë për ta bërë atë produkt të sigurt.

1.3. për çdo produkt që mund të paraqesë rreziqe për persona të caktuar:

1.3.1. të urdhërojë që ata të paralajmërohen për rrezikun në kohën e duhur dhe në një formë të përshtatshme, përfshirë publikimin e paralajmërimeve të veçanta.

1.4. për çdo produkt që mund të jetë i rrezikshëm:

1.4.1. të ndalojë përkohësisht ofrimin, ekspozimin, dorëzimin, gjatë së cilës kohë është e nevojshme të kontrollohen vetitë e produktit që mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë.

1.5. për çdo produkt të rrezikshëm:

1.5.1. të ndalojë tregtimin e tij dhe të prezantojë masat shoqëruese të kërkuara për të siguruar që ndalimi të respektohet.

1.6. për çdo produkt të rrezikshëm që tashmë është vendosur në treg:

1.6.1. të urdhërojë ose organizojë tërheqjen e menjëhershme të tij, dhe të paralajmërojë konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë për rreziqet që paraqet produkti;

1.6.2. të urdhërojë, koordinojë ose, nëse është e përshtatshme, të organizojë së bashku me prodhuesit dhe shpërndarësit kthimin e produktit nga konsumatorët dhe përdoruesit tjerë dhe shkatërrimin e tij në kushte të përshtatshme nga dhe në shpenzimet e prodhuesve ose shpërndarësve.

1.7. për çdo produkt mashtrues të ndalojë prodhimin, importin, eksportin ose vendosjen në treg dhe shitjen, të tërheqë ose të kërkojë tërheqjen e tij nga tregu.

2. Nëse ka dëshmi se produkti është i rrezikshëm, inspektorati kompetent merr masa për të kufizuar vendosjen në treg ose kërkon tërheqjen e produkteve të rrezikshme, pavarësisht nga pajtueshmëria me kërkesën e përgjithshme të sigurisë sipas neneve 6 dhe 7 të këtij ligji.

3. Inspektorati kompetent urdhëron masën e kthimit të produktit nga nën-nënparagrafi 1.6.2 të këtij neni si masë përfundimtare, nëse të gjitha veprimet dhe masat tjera nga nenet 10, 11, 12 dhe 18 të këtij ligji, të cilat janë ndërmarrë nga prodhuesi dhe shpërndarësi vullnetarisht ose me urdhër të inspektorit kompetent, nuk janë të mjaftueshme apo të kënaqshme.

4. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni, sidomos masat nga nënparagrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij neni, merren në mënyrë proporcionale me seriozitetin e rrezikut dhe duke synuar parandalimin.

5. Kundër vendimit të inspektorit kompetent për masa nga nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë brenda tetë (8) ditëve tek organi kompetent i emëruar nga ministri i ministrisë.

6. Kundër vendimit për ndalimin e importit ose eksportit të produkteve mashtruese nga

nënparagrafi 1.7 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë brenda tetë (8) ditëve tek organi kompetent i emëruar nga ministri i ministrisë përgjegjëse për çështjet sanitare.

7. Ankesa nga paragrafi 6 i këtij neni nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

8. Kundër vendimit të organit kompetent mund të nisët kontest administrativ në gjykatën kompetente.

9. Nëse inspektorati kompetent nuk i posedon përgatitjet dhe njohuritë e nevojshme adekuate ose pajisjet e nevojshme për kryerjen e verifikimeve dhe inspektimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, mund t'ia delegojë një institucioni apo individ të kualifikuar, për kryerjen e veprimeve profesionale brenda fushëveprimtarisë mbikëqyrëse.

10. Nëse vërtetohet se produkti nuk është i sigurt për shkak të mangësive ose gabimit të bërë nga prodhuesi, shpenzimet e procedurës inspektuese i bart prodhuesi.

11. Në marrjen e masave nga paragrafi 1 i këtij neni, sidomos masat nga nënparagrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij neni, inspektorati kompetent vepron në përputhje me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, sidomos nenet 34 dhe 36 të Traktatit.

Neni 19 Adresimi i masave

1. Masat që merren nga inspektorati kompetent duhet të adresohen, sipas rastit, te:

1.1. prodhuesi;

1.2. shpërndarësi, në kuadër të fushëveprimit të tij përkatës dhe në veçanti ndaj atyre që janë përgjegjës për vendosjen e parë të produktit në tregun e Republikës së Kosovës;

1.3. çdo person tjetër juridik ose fizik, kur është e nevojshme, me qëllim të bashkëpunimit për veprimet e ndërmarra për të shmangur rreziqet që paraqiten nga një produkt.

Neni 20 Mbikëqyrja inspektuese efektive

1. Inspektoratet kompetente duhet angazhohen veçanërisht dhe të bashkëpunojnë mes vete për të siguruar mbikëqyrje inspektuese efektive që garanton një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorit.

2. Inspektoratet kompetente duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë çështjeve si në vijim:

2.1. hartimi, përditësimi periodik dhe zbatimi i programeve sektoriale të mbikëqyrjes sipas kategorive të produkteve ose rreziqeve dhe monitorimi i aktiviteteve, gjetjeve dhe rezultatet e mbikëqyrjes;

2.2. ndjekja dhe përditësimi i njohurive shkencore dhe teknike në lidhje me sigurinë e produkteve;

2.3. rishikimi dhe vlerësimi periodik i funksionimit të aktiviteteve të mbikëqyrjes inspektuese efektive, nëse është e nevojshme, rishikimi i qasjes dhe organizimit të mbikëqyrjes së vendosur.

3. Inspektoratet kompetente duhet të sigurojnë që konsumatorëve dhe palëve të tjera të interesuara t'u jepet mundësia për të paraqitur ankesa për sigurinë e produktit dhe për aktivitetet e mbikëqyrjes dhe kontrollit dhe se këto ankesa të trajtohen siç duhet.

4. Inspektoratet kompetente duhet të informojnë konsumatorët dhe palët e tjera të interesuara për procedurat e përcaktuara.

KAPITULLI VI DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 21 Gjobat

1. Gjobë prej katërmijë (4.000) euro deri në dymbëdhjetëmijë (12.000) euro i shqiptohet personit juridik që:

1.1. në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 6 të këtij ligji, vendos në treg produkt që nuk është i sigurt;

1.2. në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 6 të këtij ligji, prodhon, vendos në treg, importon ose eksporton produkt mashtrues;

1.3. në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 10 të këtij ligji, dështon t'u sigurojë konsumatorëve informacionin dhe paralajmërimet e nevojshme për vlerësimin e rrezikut të produktit gjatë gjithë periudhës së parashikuar ose periudhës normale të përdorimit të tij;

1.4. në kundërshtim me nënparagrafin 2.1 të nenit 10 të këtij ligji, në varësi të karakteristikave të produkteve të vendosura në treg, nuk merr masa që do t'i mundësonin atij të kryente një analizë dhe vlerësim në kohë, për rreziqet që mund të paraqesin këto produkte;

1.5. në kundërshtim me nënparagrafin 2.2 të nenit 10 të këtij ligji, në varësi të karakteristikave të produkteve të vendosura në treg, nuk merr masa që do t'i mundësonin atij të paralajmërojë konsumatorët për rreziqet e vlerësuara dhe të identifikuara;

1.6. në kundërshtim me nënparagrafin 2.3 të nenit 10 të këtij ligji, në varësi të karakteristikave të produkteve të vendosura në treg, nuk merr masa që do t'i mundësonin atij tërheqjen ose kthimin e produktit në mënyrë që të shmangë rreziqet e vlerësuara ose të identifikuara;

1.7. në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 12 të këtij ligji, dështon të njoftojë menjëherë me shkrim inspektoratin kompetent, se një produkt që ai ka vënë në dispozicion në treg paraqet rrezik serioz për konsumatorin.

2. Gjobë prej treqind (300) euro deri në nëntëqind (900) euro i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni.

3. Gjobë prej njëmijëepesëqind (1.500) euro deri katërmijëepesëqind (4.500) euro i shqiptohet personit fizik për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni.

4. Gjobë prej njëmijëepesëqind (1.500) euro deri katërmijëepesëqind (4.500) euro i shqiptohet personit juridik që:

4.1. në kundërshtim me nënparagrafin 3.1 të nenit 11 të këtij ligji, dështon të sigurojë informacion në lidhje me rreziqet për pjesëmarrësit në zinxhirin e furnizimit, konsumatorët dhe inspektoratin kompetent;

4.2. në kundërshtim me nënparagrafin 3.2 të nenit 11 të këtij ligji, nuk mban dhe me kërkesë të autoriteteve shtetërore nuk siguron dhe nuk ofron dokumentet e nevojshme për origjinën e produktit dhe identifikimin e prodhuesit;

4.3. në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 12 të këtij ligji, dështon të njoftojë menjëherë me shkrim inspektoratin kompetent se produkti që ka vendosur në treg është i rrezikshëm;

4.4. në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 12 të këtij ligji, nuk bashkëpunon me inspektoratin kompetent në lidhje me veprimet e ndërmarra për të shmangur rreziqet që vijnë nga produktet që i vendos në treg ose i vë në dispozicion në treg.

5. Gjobë prej një mijë (1.000) euro deri në tremijë (3.000) euro i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për shkeljet nga paragrafi 4 i këtij neni.

6. Gjobë prej treqind (300) euro deri nëntëqind (900) euro i shqiptohet personit fizik për shkeljet nga paragrafi 4 i këtij neni.

Neni 22

Përrjashtim nga vendosja e gjobës

Inspektori nuk shqipton gjoba sipas nenit 21 të këtij ligji, nëse prodhuesi ose shpërndarësi ndërmerr vullnetarisht masa për të përmbushur kërkesat e zbatueshme të sigurisë ose bashkëpunon plotësisht me inspektoratin kompetent sipas këtij ligji.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Aktet nënligjore

1. Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj nxirren brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Për aq sa nuk janë në kundërshtim me këtë ligj, zbatohen deri kur të zëvendësohen këto akte nënligjore:

2.1.Rregullore (MTI) nr.08/2013 për mënyrën e themelimit dhe funksionimit të sistemit për shkëmbimin e shpejtë të informacioneve për produktet e rrezikshme;

2.2.Rregullore (MTI) nr.13/2012 për njoftim në lidhje me produktet të cilat janë të rrezikshme për konsumatorët.

Neni 24

Zbatimi i vendimit të Komisionit Evropian

Kur konsiderohet i nevojshëm miratimi i një akti të veçantë për zbatimin e vendimit të Komisionit Evropian i cili ndalon ose kufizon vendosjen në treg dhe eksportin e një produkti ose grupi produktesh të caktuar që paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorit, Qeveria e Republikës së Kosovës jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga vendimi i Komisionit Evropian, nxjerr vendim me të cilin përcaktohen veprimet e prodhuesve dhe shpërndarësve në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit Evropian.

Neni 25
Kuptimi i termave pas hyrjes në Bashkimin Evropian

Nga dita e hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, prodhuesi me seli qendrore, ose vendbanim në Republikën e Kosovës, për qëllime të këtij ligji, do të thotë një prodhues me seli qendrore, ose vendbanim në Bashkimin Evropian.

Neni 26
Shtyrja e zbatimit

Në ditën e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, zbatohen neni 14 paragrafi 5, neni 16 dhe neni 18 paragrafi 11 të këtij ligji.

Neni 27
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr.04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Ligji nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-078 Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr.08/L-172
9 mars 2023

Shpallur me dekretin Nr. DL-59/2023, datë 24.03.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu